



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 59 datë 7.11.2022

**“PËR MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E
STREHIMIT SOCIAL PËR VITIN 2022”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen bendore“ i ndryshuar ; pika 1,2,3 e neni 15, neni 16 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“; pika 12 germa ‘a‘ të VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore“; VKM nr. 362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij“; “VKM nr.453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti” i ndryshuar ; VKM nr.405, datë 01.06.2016 “Për miratimin e strategjisë të strehimit social 2016-2025“; Shkresë nr.16192 prot, datë 23.9.2021 të Ministrisë së Financave dhe ekonomisë “Mbi sistemin online dhe banesave sociale“; Shkresë nr.5729 prot, datë 29.3.2022 e e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” Mbi zbatimin e sistemin e strehimit në e-Albania” si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:


1. Të miratojë sistemet e pikëzimit për programet e strehimit social për vitin 2022 të Bashkisë Shkodër, si më poshtë :
 - Te miratojë sistemin e pikëzimit për programin ‘Banesa sociale me qira/subvencionimi i qirasë në treg të lire’ sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.

- Te miratojë sistemin e pikëzimit për programin ‘Banesa me kosto të ulët/subvencionimi i interesave të kredisë’ sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.
- Te miratojë mënyrën e vlerësimit dhe llogaritja e sistemit të pikëzimit, sipas Aneksit 3, bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR



Sekretari i Këshillit Bashkiak

A blue ink signature of Denis Lasha.

Denis Lasha

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur me datë 11.11.2022

Aneksi 1

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA/SUBVENCIONIMI I QIRASË NË TREG TË LIRË		
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
A	Nuk disponon banesë në pronësi	7
B	Banesa në rrezik shembje;	6
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	4
Ç	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	3
D	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zbatimit të një vendimi gjyqësor;	2
DH	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	3
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë;	7
B	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	5
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	6
Ç	Bashkëshortët, moshë e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç;	5
D	Asnjë nga kushtet	2
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
A	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	2
B	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	3
C	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të liritimit të banesave të ish-pronarëve.	1
Ç	Emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë	1
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	1
DH	Punonjës i reparteve FNSH dhe RENEA.	1
E	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;	1

Ë	Viktima të dhunës në familje.	2
F	Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit.	2
G	Anëtar i minoretit Rom	3
GJ	Anëtar të minoretit Egjiptian	1
H	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur,	1
I	Vajzë Nënë.	2
J	Individë që i përket komunitetit LGBTI, i cili ka një vendim të organit kompetent si viktimë e orientimit seksual ose identitetit gjinor.	1
k	Azilkërkues;	1
l	Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike;	1
m	Asnjë nga kushtet	1
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	Familje pa të ardhura;	9
B	Familje me të ardhura shumë të ulëta, nën 70% të të ardhurave mesatare;	7
C	Familje me të ardhura të ulëta 70%-100% të të ardhurave mesatare;	5
D	Familje me të ardhura mesatare 100%-120% të të ardhurave mesatare;	4

Aneks 2

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT/SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TE KREDISË		
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
A	Nuk disponon banesë në pronësi	7
B	Banesa në rrezik shembje;	4
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	4
Ç	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	4
D	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zbatimit të një vendimi gjyqësor;	3
DH	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	3
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë;	4
B	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	3
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	7
Ç	Bashkëshortët, mosha e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç/ Cifte të reja dhe të rinj me moshë jo më të madhe se 35 vjeç.	10
D	Asnjë nga kushtet	1
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
A	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;	3
B	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	2
C	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve.	0
Ç	Emigrantë i rikthyer, punëtorë emigrantë	3
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0
DH	Punonjës i reparteve FNSH dhe RENEA.	3
E	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;	2

E	Viktima të dhunës në familje.	2
F	Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit.	2
G	Anëtar i minoretit Rom	1
GJ	Anëtar të minoretit Egjiptian	1
H	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur,	1
I	Vajzë Nënë.	1
J	Individë që i përket komunitetit LGBTI, i cili ka një vendim të organit kompetent si viktimë e orientimit seksual ose identitetit gjinor.	1
k	Azilkërkues;	1
l	Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike;	1
m	Asnjë nga kushtet	1
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
A	Familje pa të ardhura;	0
B	Familje me të ardhura shumë të ulëta, nën 70% të të ardhurave mesatare;	6
C	Familje me të ardhura të ulëta, 70%-100% të të ardhurave mesatare;	9
D	Familje me të ardhura mesatare 100%-120% të të ardhurave mesatare;	10

Aneksi 3

Mënyra e vlerësimit dhe llogaritja e sistemit të pikëzimit:

- I.** Pikët maksimale sipas kriterëve të pikëzimit janë 25 pikë për secilin nga kushtet e paraqitura në tabelën përkatëse me nënndarjet 1.1;1.2;1.3;1.4.
- II.** Pikët nuk mund të mblidhen brenda për brenda kushteve si më poshtë:
 - 1.1-Kushtet e strehimit
 - 1.2-Kushtet familjare
 - 1.4-Kushtet ekonomike
- III.** Pikët nga A deri në fund të kriterit 1.3 Kushtet sociale, mund të mblidhen bashkë deri në tre gërma.